



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 29.10.2025
NR.09/ 9112 /2025

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës¹: 659-25-9621-1-4-7/C691 & KKHE(VM) 25-031-1-4-7

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Alfa Dent SH.P.K., Rr.Ali Tepelena pn., 70000, Ferizaj me NUI.811492511, (në vazhdim "Ofruesi i furnizimit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim e shënuara me poshtë:

Furnizim me material stomatologjik me numër identifikues: 659-25-9621-1-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të furnizimit:

No.	
1	Furnizim me material stomatologjik

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **996.10 €**; [Nëntqind e nëntdhjetë e gjashtë euro /10 cent]
Euro. Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej një (1) muaj nga nënshkrimi i saj mes palëve

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në rast të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Neni 4

Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e furnizimit.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar i përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	29.10.2025
Vula:	

Për Ofruesin e furnizimit Alfa Dent SH.P.K

Emri:	Labinot Llabjani
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	29.10.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-9621-1-4-7/C691

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Gdhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënime kursive të përindeura për t'u nënshkruar në KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Ferizaj dega në Kaçanik.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të furnizimit është <i>[29.10.2025]</i> .
	6.4	Data e Përfundimit është <i>[28.11.2025]</i> .
	6.5	Vendi i kryerjes së furnizimit është <i>[QKMF Dr. Menduh Kaloshi –Hani i Elezit]</i>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxhcri i Projektit është <i>N/A</i> <i>Per ecurin e kesaj kontrate kujdeset DSHMS-ja respektivisht QKMF-Dr.Menduh Kaloshi –Hani i Elezit</i>
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është <i>[0.25%]</i> në ditë për furnizime të parealizuara Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është <i>[10%]</i> të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: <i>N/A</i>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i> c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i> d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i> e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>[shëno shumën]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>[Pagesa do te realizohet pas realizimit te furnizimit]</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	AK do te kontrolloj cilesin dhe sasin e relizimit te furnizimit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zyra e Prokurimit –Komuna e Hani te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifikoni organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifikoni rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjet e Tregëtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .